

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 320

MATERIALITETI NË PLANIFIKIMIN DHE NË KRYERJEN E NJË AUDITIMI

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Materialiteti në kontekstin e një auditimi	2-6
Hyrja në fuqi	7
Objektivi	8
Përkufizimi	9
Kërkesat	
Përcaktimi i materialitetit dhe i performancës së tij në planifikimin e auditimit	10-11
Rishikimi gjatë zhvillimit të auditimit	12-13
Dokumentimi	14
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Materialiteti dhe rreziku i auditimit	A1
Materialiteti në kontekstin e një auditimi	A2
Përcaktimi i materialitetit dhe i performancës së tij në planifikimin e auditimit	A3-A13
Rishikimi gjatë zhvillimit të auditimit	A14

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 320, “Materialiteti në Planifikimin dhe në Kryerjen e një Auditimi” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA), trajton përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare. SNA 450¹ shpjegon se si zbatohet materialiteti në vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuar në auditim dhe të anomalive të pakorrigjuara, nëse ka, në pasqyrat financiare.

Materialiteti në kontekstin e një auditimi

2. Kuadrot e raportimit financiar shpesh e trajtojnë konceptin e materialitetit në kontekstin e përgatitjes dhe të paraqitjes së pasqyrave financiare. Edhe pse kuadrot e raportimit financiar mund ta trajtojnë materialitetin në drejtime të ndryshme, përgjithësisht shpjegojnë se:
 - Anomalitë, duke përfshirë edhe mungesat, konsiderohen të jenë materiale në qoftë se ato, individualisht ose së bashku, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike që merren nga ana e përdoruesve bazuar në pasqyrat financiare;
 - Gjykimet në lidhje me materialitetin bëhen sipas rrethanave përkatëse, dhe ndikohen nga madhësia apo natyra e një anomalie, apo nga një kombinim i të dyjave, dhe
 - Gjykimet në lidhje me çështjet që janë materiale për përdoruesit e pasqyrave financiare bazohen në nevojat e përbashkëta për informacion financiar të përdoruesve si një grup.² Nuk merret parasysh efekti i mundshëm i anomalive për përdoruesit individualë të veçantë, nevojat e të cilëve janë krejt të ndryshme.
3. Një trajtim i tillë, nëse është i pranishëm në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, përbën një kuadër referimi për audituesin në përcaktimin e materialitetit në auditim. Nëse kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar nuk përfshin një trajtim të konceptit të materialitetit, karakteristikat e përmendura në paragrafin 2 përbëjnë për audituesin një kuadër të tillë referimi.
4. Përcaktimi i materialitetit nga audituesi është një çështje e gjyimit profesional dhe ndikohet nga perceptimi i audituesit i nevojave për informacion financiar të përdoruesve të pasqyrave financiare. Në këtë kontekst, është e arsyeshme për audituesin të supozojë që përdoruesit:

¹ SNA 450, *Vlerësimi i Anomalive të Identifikuara gjatë Auditimit*.

² Për shembull, “*Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare*”, i miratuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Prill 2001, tregon se, për një entitet fitimprurës, meqë investitorë janë ofruesit e kapitalit të rrezikut në ndërmarrje, sigurimi i pasqyrave financiare që plotëson nevojat e tyre gjithashtu do të plotësojë shumicën e nevojave të përdoruesve të tjerë të këtyre pasqyrave.

MATERIALITETI NË PLANIFIKIMIN DHE KRYERJEN E NJË AUDITIMI

- (a) Kanë një njohuri të arsyeshme të biznesit, aktiviteteve ekonomike dhe kontabilitetit, dhe janë të gatshëm për të studiuar informacionin në pasqyrat financiare me kujdes të arsyeshëm;
 - (b) Kuptojnë se pasqyrat financiare janë përgatitur, paraqitur dhe audituar në nivelet e materialitetit;
 - (c) Njohin pasiguritë e vetvetishme në matjen e shumave bazuar në përdorimin e vlerësimeve, gjykimit dhe në parashikimin e ngjarjeve të ardhshme; dhe
 - (d) Marrin vendime të arsyeshme ekonomike në bazë të informacionit në pasqyrat financiare.
5. Koncepti i materialitetit përdoret nga ana e audituesit si gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit, ashtu dhe në vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuara në auditim dhe të anomalive të pakorrigjuara, nëse ka të tilla, në pasqyrat financiare dhe në formimin e opinionit në raportin e audituesit. (Ref: Para. A1)
6. Në planifikimin e auditimit, audituesi gjykon në lidhje me anomalitë që do të quhen materiale. Ky gjykim përbën bazën për:
- (a) Përcaktimin e natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut;
 - (b) Identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale, dhe
 - (c) Përcaktimin e natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit.

Materialiteti i përcaktuar gjatë planifikimit të auditimit nuk është medoemos një madhësi nën të cilën anomalitë e pakorrigjuara, individualisht apo në grup, gjithmonë do të vlerësohen si jomateriale. Rrethanat që lidhen me disa anomali mund të bëjnë që audituesi t'i vlerësojë ato si materiale edhe në qoftë se ato janë poshtë nivelit të materialitetit. Nuk është e mundur të hartohen procedura të auditimit për të zbuluar të gjitha anomalitë që mund të jenë materiale vetëm për shkak të natyrës së tyre. Megjithatë, vlerësimi i natyrës së anomalive potenciale në informacionet shpjeguese duhet për të hartuar procedurat e auditimit që adresojnë rreziqet e anomalisë materiale³(21). Veç kësaj, kur vlerëson efektin në pasqyrat financiare të të gjitha anomalive të pakorrigjuara, audituesi shqyrton jo vetëm madhësinë, por edhe natyrën e anomalive të pakorrigjuara, dhe rrethanat e veçanta të ndodhjes së tyre⁴. (Ref: Para. A2)

³ Shiko SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*, paragrafët A128a – A128b

⁴ SNA 450, paragrafi A16.

Hyrja në fuqi

7. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

8. Objektivi i audituesit është që të zbatojë siç duhet konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e auditimit.

Përkufizimi

9. Për qëllime të SNA-ve, performanca e materialitetit tregon shumën ose shumat e përcaktuara nga audituesi, më të vogla se materialiteti për pasqyrat financiare në tërësi, për të zvogëluar në një nivel të ulët të përshtatshëm probabilitetin që totali i anomalive të korrigjuara dhe të pakorrigjuara të tejkalojë materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi. Nëse është e zbatueshme, performanca e materialitetit gjithashtu i referohet shumës apo shumave të përcaktuara nga audituesi më të vogla se niveli apo nivelet e materialitetit për klasa të veçanta të transaksioneve, teprica në llogari ose informacione shpjeguese të dhëna.

Kërkesat

Përcaktimi i materialitetit dhe i performancës së tij kur bëhet planifikimi i auditimit

10. Audituesi duhet të përcaktojë materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi kur harton strategjinë e përgjithshme të auditimit. Nëse, në rrethana të veçanta të entitetit, ka një apo më shumë klasa të veçanta të transaksioneve, teprica në llogari ose informacione shpjeguese për të cilat anomalitë me shuma më të ulta se materialiteti për pasqyrat financiare në tërësi mund të pritet të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga ana e përdoruesve bazuar në pasqyrat financiare, audituesi do të përcaktojë nivelin ose nivelet e materialitetit që do të zbatohen për këto klasa të veçanta të transaksioneve, teprica në llogari ose informacione shpjeguese. (Ref: Para. A3- A12)
11. Audituesi duhet të përcaktojë performancën e materialitetit për qëllime të vlerësimit të rrezeve të anomalive materiale dhe përcaktimin e natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të mëtejshme të auditimit. (Ref: Para. A13)

Rishikimi gjatë zhvillimit të auditimit

12. Audituesi duhet të rishikojë materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi (dhe, nëse është e përshtatshme, nivelin ose nivelet e materialitetit të klasave të veçanta të transaksioneve, tepricave në llogari ose të informacioneve shpjeguese) në rastin kur bëhet i vetëdijshëm gjatë auditimit për informacionin që do ta çonte atë në përcaktimin e një shume (ose shumave) të ndryshme nga ajo e fillimit. (Ref: Paragrafi A14)

13. Nëse audituesi mendon që duhet një materialitet më i ulët për pasqyrat financiare në tërësi (dhe, nëse është e përshtatshme, niveli ose nivelet e materialitetit të klasave të veçanta të transaksioneve, tepricave në llogari ose të informacioneve shpjeguese) se sa ai që është përcaktuar fillimisht, atëherë ai duhet të përcaktojë nëse është e nevojshme që të rishikojë performancën e materialitetit dhe nëse natyra, afati dhe shtrirja e procedurave të mëtejshme të auditimit mbeten të përshtatshme.

Dokumentimi

14. Audituesi duhet të përfshijë në dokumentacionin e auditimit shumat e mëposhtme dhe faktorët që janë marrë parasysh në përcaktimin e tyre⁵:

- (a) Materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi (shiko paragrafin 10);
- (b) Nëse është e përshtatshme, nivelin ose nivelet e materialitetit të klasave të veçanta të transaksioneve, tepricave në llogari ose të informacioneve shpjeguese të dhëna (shiko paragrafin 10);
- (c) Performancën e materialitetit (shiko paragrafin 11); dhe
- (d) Çdo rishikim i (a) - (c) gjatë zhvillimit të auditimit (shiko paragrafët 12-13).

Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese

Materialiteti dhe rreziku i auditimit (Ref: Para. 5)

A1. Në kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, objektivat e përgjithshme të audituesit janë që të përftojë sigurinë e arsyeshme për pasqyrat financiare në tërësi nëse janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, duke bërë të mundur që ai të shprehë një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar; të raportojë mbi pasqyrat financiare dhe të komunikojë siç kërkohet nga SNA-të, në përputhje me gjetjet e tij⁶. Audituesi arrin siguri të arsyeshme nëpërmjet përftimit të evidencës së mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit për të zvogëluar rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm⁷. Rreziku i auditimit është rreziku që audituesi shpreh një opinion auditimi të papërshtatshëm kur pasqyrat financiare kanë anomali materiale. Rreziku i auditimit është një funksion i rreziqeve të anomalive materiale dhe i rrezikut të moszbulimit⁸. Materialiteti dhe rreziku i auditimit merren parasysh gjatë gjithë auditimit, në mënyrë të veçantë, kur:

⁵ SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët 8-11 dhe A6.

⁶ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 11.

⁷ SNA 200, paragrafi 17.

⁸ SNA 200, paragrafi 13(c).

- (a) Identifikohen dhe vlerësohen rreziqet e anomalive materiale⁹;
- (b) Përcaktohen natyra, afati dhe shtrirja e procedurave të mëtejshme të auditimit¹⁰, dhe
- (c) Vlerësohet efekti i anomalive të pakorrigjuara, nëse ka të tilla, në pasqyrat financiare¹¹ dhe në formimin e opinionit në raportin e audituesit.¹²

Materialiteti në Kontekstin e një Auditimi (Ref: Para. 6)

A2. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale (23) përfshin përdorimin e gjykimit profesional për të identifikuar ato klasa të transaksioneve, teprica llogarish dhe informacione shpjeguese, përfshirë informacionet shpjeguese cilësore, të cilat mund të kenë anomali materiale (që do të thotë se në përgjithësi, informacionet financiare do të konsiderohen materiale nëse ato, në mënyrë të arsyeshme parashikohet të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e pasqyrave financiare në tërësi). Kur vlerëson nëse anomali të në informacionet shpjeguese cilësore mund të jenë materiale, audituesi mund të identifikojë faktorët e mëposhtëm:

- Rrethanat e entitetit për periudhën (për shembull, entiteti mund të ketë realizuar një kombinim të rëndësishëm biznesi gjatë kësaj periudhe);
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, përfshirë ndryshimet e tij (për shembull, një standard i ri i raportimit financiar mund të kërkojë informacione shpjeguese cilësore të reja, të cilat janë të rëndësishëm për entitetin);
- Informacionet shpjeguese cilësore, të cilët janë të rëndësishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, për shkak të natyrës së entitetit (për shembull, rreziqet e dhënies së informacioneve shpjeguese për likuiditetin mund të jenë të rëndësishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare të një institucioni financiar).

Përcaktimi i materialitetit dhe i performancës së tij kur bëhet planifikimi i auditimit

Konsiderata të veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A3. Në rastin e një entiteti të sektorit publik, përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të tij janë shpesh ligjvënësit dhe rregullatorët. Për më tepër, pasqyrat financiare mund të përdoren për të marrë vendime të tjera përveç atyre ekonomike. Përcaktimi i materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi (dhe, nëse është e përshtatshme, niveli ose nivelet e materialitetit të klasave të veçanta të transaksioneve, tepricave në llogari

⁹ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*.

¹⁰ SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara*.

¹¹ SNA 450.

¹² SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i Opinionit dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*.

ose të informacioneve shpjeguese) në një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të sektorit publik është, pra, i ndikuar nga ligji, rregullimet apo një autoritet tjetër, dhe nga nevojat për informacion financiar të ligjvënësve dhe publikut në lidhje me programet e sektorit publik.

Përdorimi i kufijve në përcaktimin e materialitetit për Pasqyrat Financiare në tërësi (Ref: Para. 10)

- A4. Përcaktimi i materialitetit përfshin ushtrimin e gjykimit profesional. Shpesh përdoret një përqindje si një kufi i zgjedhur që shërben si një pikënisje në përcaktimin materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi. Faktorët, që mund të ndikojnë në identifikimin e një kufiri të përshtatshëm, përfshijnë në vijim:
- Elementët e pasqyrave financiare (për shembull, aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet);
 - Nëse ka zëra tek të cilët synohet të përqëndrohet vëmendja e përdoruesve të pasqyrave financiare të entitetit të veçantë (për shembull, për qëllime vlerësimi të performancës financiare përdoruesit mund të synojnë të përqëndrohen tek fitimi, të ardhurat ose aktivet neto);
 - Natyra e entitetit, ku është entiteti në ciklin e tij të jetës, sektori dhe mjedisi ekonomik në të cilin vepron entiteti;
 - Struktura e pronësisë e entitetit dhe mënyra se si është financuar (për shembull, nëse një njësi ekonomike është financuar vetëm nëpërmjet borxhit në vend të kapitalit neto, përdoruesit mund t'i kushtojnë më tepër rëndësi aktiveve dhe të drejtave mbi to se sa fitimeve të entitetit; dhe
 - Paqëndrueshmëria relative e kufirit.
- A5. Shembuj të kufijve që mund të jenë të përshtatshëm, në varësi të rrethanave të njësisë ekonomike, përfshijnë kategoritë e të ardhurave të raportuara të tilla si fitimi para tatimit, të ardhurat totale, fitimi bruto dhe shpenzimet totale, totali i kapitalit neto ose vlera e aktiveve neto. Fitimi para tatimit nga operacionet e vazhdueshme përdoret shpesh për njësitë ekonomike fitimprurëse. Kur fitimi para tatimit nga operacionet e vazhdueshme është i paqëndrueshëm, mund të jenë më të përshtatshëm kufij të tjerë, të tillë si fitimi bruto ose të ardhurat totale.
- A6. Në lidhje me kufirin e zgjedhur, të dhënat përkatëse financiare, zakonisht, përfshijnë rezultatet dhe pozicionet financiare të periudhave të mëparshme, rezultatet financiare dhe pozicionin financiar nga fillimi i periudhës deri në momentin aktual, dhe buxhetet apo parashikimet për periudhën aktuale, të rregulluara për ndryshimet e rëndësishme në rrethanat e entitetit (për shembull, një blerje e rëndësishme biznesi) dhe ndryshimet përkatëse të kushteve në industrinë apo në mjedisin ekonomik në të cilin vepron entiteti. Për shembull, kur, për një entitet të veçantë, si një pikënisje, materialiteti për

pasqyrat financiare në tërësi është përcaktuar bazuar në një përqindje të fitimit para tatimit nga operacionet e vazhdueshme, rrethanat që shkaktojnë një rënie apo rritje të jashtëzakonshme në këtë fitim mund të bëjnë që audituesi të arrijë në përfundimin se është më e përshtatshme që materialiteti për pasqyrat financiare në tërësi të përcaktohet duke përdorur një fitim të normalizuar para tatimit nga operacionet e vazhdueshme bazuar në rezultatet e kaluara.

- A7. Materialiteti ka të bëjë me pasqyrat financiare për të cilat audituesi raporton. Në rastin kur pasqyrat financiare janë përgatitur për një periudhë raportimi financiar më tepër ose më pak se dymbëdhjetë muaj, siç mund të jetë rasti për një entitet të ri ose kur ka një ndryshim në periudhën e raportimit financiar, materialiteti ka të bëjë me pasqyrat financiare të përgatitura për këtë periudhë raportimi financiar.
- A8. Në përcaktimin e një përqindjeje, që do të përdoret si një kufi i zgjedhur, kërkohet të ushtrohet gjykimi profesional. Ka një lidhje midis përqindjes dhe kufirit të zgjedhur, e tillë që një përqindje e zbatuar në fitimin para tatimit nga operacionet e vazhdueshme normalisht do të jetë më e lartë se një përqindje që zbatohet për të ardhurat e përgjithshme. Për shembull, për një entitet fitimprurës në një industri prodhuese, audituesi mund ta quajë të përshtatshme të përdorë pesë për qind të fitimit para tatimit nga operacionet e vazhdueshme, ndërsa për një entitet jo-fitimprurës ai mund ta quajë të përshtatshme një për qind të të ardhurave totale ose të shpenzimeve totale. Megjithatë, sipas rrethanave, mund të mendohen të përshtatshme përqindje më të larta apo më të ulëta.

Konsiderata të veçanta për Entitetet e Vogla

- A9. Kur fitimi para tatimit nga operacionet e vazhdueshme të një entiteti është vazhdimisht nominal, siç mund të jetë rasti për një biznes i menaxhuar nga pronari, ku ky merr në formën e shpërblimit një pjesë të mirë të fitimit para tatimit, si kufi më i përshtatshëm mund të jetë fitimi para shpërblimit dhe tatimit.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet në Sektorin Publik

- A10. Në një auditim të një entiteti të sektorit publik, kostoja totale ose kostoja neto (shpenzimet minus të ardhurat ose pagesat minus arkëtimet) mund të jenë kufij të përshtatshëm për aktivitetet e programit. Kur një entitet i sektorit publik ka kujdestarinë e aktiveve publike, një kufi i përshtatshëm mund të jenë aktivet.

Niveli ose nivelet e materialitetit për klasat e veçanta të transaksioneve, tepricat në llogari ose informacionet shpjeguese të dhëna (Ref: Para. 10)

- A11. Faktorët që mund të tregojnë për ekzistencën e një ose më shumë klasave të veçanta të transaksioneve, tepricave në llogari ose informacioneve shpjeguese, për të cilat anomalitë në shuma më të vogla se materialiteti për pasqyrat financiare në tërësi pritet, në mënyrë të arsyeshme, që të ndikojnë në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit bazuar në pasqyrat financiare, përfshijnë si në vijim:

- Nëse ligji, rregullorja apo kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar ndikojnë në pritshmëritë e përdoruesve në lidhje me matjen ose dhënien e informacioneve shpjeguese për zëra të caktuara (për shembull, transaksionet midis palëve të lidhura, shpërblimi i drejtimit dhe i personave që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe analizat e ndjeshmërisë për çmuarjet kontabël me vlerën e drejtë që ka një pasiguri të lartë çmuarje).
- Dhënia e informacioneve shpjeguese kryesore në lidhje me industrinë në të cilën vepron entiteti (për shembull, kostot e kërkimit dhe të zhvillimit për një kompani farmaceutike).
- Nëse vëmendja është e përqendruar në një aspekt të veçantë të biznesit të entitetit për të cilin është dhënë informacion shpjegues veçmas në pasqyrat financiare (për shembull, informacionet shpjeguese për segmentet në një kombinim biznesi të rëndësishëm)

A12. Në rastin kur, në rrethana specifike të entitetit, ekzistojnë klasa të tilla të transaksioneve, tepricave në llogari ose informacioneve shpjeguese, audituesi mund ta gjejë të dobishme të njihet me pikëpamjet dhe pritshmëritë e personave që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe drejtimin.

Performanca e Materialitetit (Ref: Para. 11)

A13. Planifikimi i auditimit vetëm për të zbuluar anomalitë materiale individuale lë mënjanë faktin se totali i anomalive individualisht jomateriale mund të krijojë anomali materiale në pasqyrat financiare dhe nuk lë hapësirë për anomalitë e mundshme të pazbuluara. Performanca e materialitetit (i cili, siç është përkufizuar, është shuma ose shumat) vendoset për të reduktuar në një nivel të ulët të përshtatshëm probabilitetin që totali i anomalive të pakorrigjuara dhe të pazbuluara në pasqyrat financiare tejkalon materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi. Në mënyrë të ngjashme, performanca e materialitetit që lidhet me një nivel materialiteti të përcaktuar për një klasë të veçantë të transaksioneve, tepricave në llogari ose informacioneve shpjeguese të dhëna vendoset për të reduktuar në një nivel të ulët të përshtatshëm probabilitetin që totali i anomalive të pakorrigjuara dhe të pazbuluara në këtë klasë të veçantë të transaksioneve, tepricave në llogari ose informacioneve shpjeguese të dhëna tejkalon nivelin e materialitetit për to. Përcaktimi i performancës të materialitetit nuk është një llogaritje e thjeshtë mekanike, por përfshin ushtrimin e gjykimit profesional. Ajo ndikohet nga njohja e entitetit nga ana e audituesit, e përditësuar gjatë kryerjes së procedurave të vlerësimit të rrezikut; si dhe nga natyra dhe shtrirja e anomalive të identifikuara në auditimet e mëparshme dhe si rrjedhim nga pritshmëritë e audituesit në lidhje me anomalitë në periudhën aktuale.

Rishikimi gjatë zhvillimit të auditimit (Ref: Para. 12)

A14. Materialiteti për pasqyrat financiare në tërësi (dhe, nëse është e përshtatshme, niveli ose nivelet e materialitetit për klasa të veçanta të transaksioneve, tepricat në llogari ose informacionet shpjeguese) mund të ketë nevojë të rishikohet si rezultat i një ndryshimi në rrethanat që kanë ndodhur gjatë kryerjes së auditimit (për shembull, një vendim për të shitur një pjesë të madhe të biznesit të entitetit), informacioni të ri, apo një ndryshimi në njohjen nga ana e audituesit të entitetit dhe të veprimtarive të tij si rezultat i kryerjes së procedurave të mëtejshme të auditimit. Për shembull, në qoftë se gjatë auditimit duket sikur rezultatet financiare aktuale ka të ngjarë të jenë thelbësisht të ndryshme nga rezultatet e parashikuara nga fillimi i periudhës deri në momentin aktual, që janë përdorur fillimisht për të përcaktuar materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi, audituesi e rishikon këtë materialitet.